



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media
Mbledhja nr. 11
Prishtinë, më 04.07.08 ora: 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Esat Brajshori, Fehmi Mujota, Shpresa Murati, Melihate Tërmkollli, Gani Buçinca, Hajdin Abazi, Anita Morina, Synavere Rysha, Radmila Vujovic, Ali Lajçi dhe Rasim Selmanaj.

Në mbledhje morri pjesë: Besim Kajtazi – Drejtor i Zyrës Ligjore – MSHP.

Nga zyra koordinuese e komisionit morën pjesë: Shpresa Ramosaj, Drita Morina, Fatime Qorri dhe Mirjeta Heta.

Mbledhjen e kryesoi kryetari i Komisionit, Esat Brajshori.

Për këtë mbledhje është propozuar ky rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës,**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.**
- 3. Takim me përfaqësuesin e MSHP-së lidhur me shqyrtimin e Projektligjit për Statistikat Zyrtare të Republikës së Kosovës nr. L – 062/1.**
- 4. Të ndryshme.**

Kryesuesi, konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua me një ndryshim, në pikën e dytë e rendit të ditës, u shqyrtua Përfundimi i Kryesisë së Kuvendit të dt. 2 korrik 2008, lidhur me Projektligjin për Statistikat Zyrtare të Republikës së Kosovës nr. L – 062/1.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar

Shpresa Murati – pati vërejtje në procesverbal te votimi i amendamentit dy të Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim në Projektligjin për Vulat në Institucionet e Republikës së Kosovës.

Vërejtja e saj ishte që në procesverbal nuk ishte konstatuar votimi i saj “Për” për amendamentin 2, i cili amendament nuk u përkrah nga Komisioni me 6 vota “Kundër” dhe 2 vota “Për”.

Konstatohet se “Për” kanë votuar Shpresa Murati dhe Radmila Vujovic.

Kryetari i Komisionit - konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalin e mbledhjes të dt. 27.06.08, me vërejtje.

3. Shqyrtimi i Përfundimit të Kryesisë së Kuvendit të dt. 2 korrik 2008, lidhur me Projektligjin për Statistikat Zyrtare të Republikës së Kosovës nr. L – 062/1.

Esat Brajshori – i njoftoi anëtarët e Komisionit me Përfundimin e Kryesisë së Kuvendit, me të cilin Përfundim, Kryesia e Kuvendit ka mbështetur kërkesën e Kryeministrit të Kosovës për tërheqjen e Projektligjit për Statistikat Zyrtare, pas miratimit të Projektligjit në parim. Gjithashtu, ai tha se qëllimi i tërheqjes së Projektligjit është kostoja e lartë financiare.

Melihate Tërmkollli – duke mbështetur Përfundimin e Kryesisë së Kuvendit për tërheqjen e Projektligjit, propozoi që Komisioni duhet të jap edhe vërejtje të tjera me arsyetimin se tërheqja e Projektligjit nuk ka të bëjë vetëm me probleme financiare por edhe me statusin e institucionit. Lidhur me këtë, propozimi i saj ishte që Enti i Statistikave të Kosovës të jetë institucion i pavarur jashtë ombrellës së MSHP-së. Ajo propozoi, që të ftohet Ministri i MSHP-së, në kohën kur do të shqyrtohet Projektligji.

Fehmi Mujota – mbështeti Përfundimin e Kryesisë së Kuvendit sipas kërkesës së Qeverisë dhe propozoi që Komisioni të jap rekomandimin për kthimin e Projektligjit.

Gani Buçinca – ai mbështeti diskutimin e znj. Tërmkollli që Qeveria ti rishikojë mundësitë që ky mekanizëm të jetë i pavarur.

Besim Kajtazi – Drejtor i Zyrës Ligjore – MSHP – në mbështetje të qëndrimit të Qeverisë për tërheqjen e Projektligjit në fjalë, ne si Ministri do ti kemi parasysh të gjitha vërejtjet e Komisionit në kohën e rishikimit të Projektligjit, pas tërheqjes, meqë kjo hyn në kuadër të politikave të Qeverisë, e cila ka qëndrimet e veta lidhur me statusin se çfarë do ta ketë Enti i Statistikave të Kosovës.

Esat Brajshori – konstatoi se, Komisioni unanimisht përkrahu Përfundimin e Kryesisë së Kuvendit dhe lidhur me këtë nxori rekomandim:

Në pajtim me rregullën 41.2 të Rregullores së Punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Komisioni për Shërbime Publike Administratë Lokale dhe Media duke u mbështetur në përfundimin e Kryesisë së Kuvendit të dt. 02.07.2008 dhe shkresën e kryeministrit të Kosovës Nr. 0789 të datës 02.27.2008, Kuvendit i

REKOMANDON

Të përkrah kërkesën e Qeverisë së Republikës së Kosovës për tërheqjen nga procedura e shqyrtimit të Projektligjit për Statistikat Zyrtare të Republikës së Kosovës.

4. Të ndryshme -

Kryetari i Komisionit – hapi debat rreth amendamentit 2 të Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim në Projektligjin për Vulat në Institucionet e Republikës së Kosovës.

Amendamenti 2

Në nenin 8, paragrafin 3 (i) të Projektligjit, në tekstin në gjuhën serbe, fshihen fjalët **Republike Kosova** dhe zëvendësohen me fjalët **“Republika Kosovo”**.

Melihate Tërmkollli – ajo tha, që Komisioni duhet të konstatoj se nuk është kompetent ta përkrah atë amendament, duke propozuar që Kryesia e Kuvendit të marrë vendim se si do të jetë vula në institucione në gjuhën serbe.

Ajo theksoi, se të gjitha ligjet duhet të jenë konform Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si akti më i lartë juridik i shtetit, ndërsa harmonizimin mes tyre duhet ta bëjnë institucionet.

Gani Buçinca – duke përkrahur parafolësen ai tha, se Komisioni nuk është Gjykatë Kushtetuese për interpretim të dispozitave kushtetuese dhe se Komisioni nuk ka kompetencë të vendos për këtë çështje.

Kryetari i Komisionit, pas diskutimeve të anëtarëve të Komisionit, propozoi që në një takim me Kryetarin e Parlamentit të diskutohet për këtë çështje dhe pastaj Komisioni të rishqyrtoj raportin me rekomandime të Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim në Projektligjin për Vulat në Institucionet e Republikës së Kosovës.

Mbledhja përfundoi në orën 13:45 min.

Përgatitur nga

Njësia për mbështetjen e Komisionit

**Kryetari i Komisionit
Esat Brajshori**